



Home > Aktualitet > Me armë pa leje në makinë/ U denoncua nga qytetarët, arrestohet 22-vjeçari ng...

AKTUALITET

Me armë pa leje në makinë/ U denoncua nga qytetarët, arrestohet 22-vjeçari nga Kurbini

Pas informacioneve të marra, 22-vjeçari me initiale L.T., banues në Fushë Gjormë, u arrestua teksa po lëvizte me makinën e tij në aksin rrugor Laç - Mamurras.



Pistoleta e 22-vjeçarit

26 Shtator, 2019 12:01

KURBIN– Një 22-vjeçar është arrestuar nga Policia pasi lëvizte me një armë zjarri tip “TT” pa leje. Ai u denoncua nga qytetarë të zonës, të cilët treguan se i riu mbante me vete armën. 

Pas informacioneve të marra, 22-vjeçari me initiale L.T., banues në Fushë Gjormë, u arrestua teksa po lëvizte me makinën e tij në aksin rrugor Laç – Mamurras.

Në cilësinë e provës materiale, Policia ka gjetur dhe sekuestruar armën e zjarri, e cila ndodhet në kroskot.

NJOFTIMI I PLOTË:

Kurbin / Bashkëpunimi me komunitetin vë në pranga një shtetas që lëvizte me armë zjarri me vete

Për më shumë bëhu pjesë e grupit më viral në Facebook, [Dosja.al](#)

Sekuestrohet arma e zjarrit tip pistoletë

Specialistët për parandalimin dhe hetimeve e krimeve në Komisaratin e Policisë Kurbin, pas informacioneve të marrë nga qytetarët se një person po lëvizte me armë zjarri me vete, kanë organizuar menjëherë punën ku si rezultat arrestuan në flagrancë shtetasin L.T. 22 vjeç, banues në Fushë Gjormë – Kurbin.

Gjatë kontrollit të tij kur po lëvizte me një mjet në aksin rrugor Laç – Mamurras, i është gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale një armë zjarri pistoletë pa leje.

Materialet procedurale u referuan Prokurorisë pranë Gjykatës Shkallës Parë Kurbin për veprën penale "Armëmbajtje pa leje".

(k.m/dosja.al)

DR LIGHT

ETIKETA: #arme pa leje ne makine

3

SHARES



Previous article

'Nami' me vjedhjet në Fier/ Banorët e revoltuar paralajmërojnë: Shteti s'ndërhyn, do ketë gjakderdhje

Next article

Ndahet nga jeta ish-presidenti i Francës, Jacques Chirac



Shto Koment